



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:242289

Datë: 07.10.2024

Numri i dokumentit: 06259750

C.nr.103/2019

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË- DEGA NE VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Leotrim Gashi, në procedurën kontestimore sipas padisë së paditësit Byroja Kosovare e Sigurimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson B.G kundër të paditurit N.R, me vendbanim në Komunën e Vushtrrisë, Rruga” Kongresi i Manastirit” nr.27, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson R.B, avokat me seli në Vushtrri, me objekt kontesti rimbursim dëmi, më datë 03.10.2024, mori këtë

A K T V E N D I M

- I. KONSIDEROHET SE ËSHTË TËRHEQUR padia C.nr.103/2019, e datës 08.03.2019 e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit, ndaj të paditurit N.R për rimbursim dëmi.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja, me datë 08.03.2019, ka paraqitur në këtë gjykatë padinë ndaj të paditurit N.R për rimbursim dëmi material dhe jomaterial.

Gjykata lidhur me këtë çështje e ka mbajtur seancën përgatitore me datë 18.07.2024, kurse ato kryesore me datë 10.09.2024, 24.09.2024 dhe 03.10.2024.

Në seancën e datës 24.09.2024, në të cilën seancë kanë qenë prezent përfaqësuesit e palëve ndërgjyqëse, (paditësja ishte përfaqësuar nga D.H) ishte caktuar që seanca e radhës e shqyrtimit kryesor në këtë çështje do të mbahej me datë 03.10.2024, në ora 9:30, duke i njoftuar se ky komunikim do të shërbente në vend të ftesave të rregullta për palët.

Mirëpo pavarësisht se paditësja ishte e njoftuar me procesverbal për seancën e datës 03.10.2024 në ora 09:30, në orarin e përcaktuar nuk ishte prezent askush si përfaqësues i paditëses, kurse në seancë prezent ka qenë vetëm përfaqësuesi i të paditurit.

Gjykata, me qëllim të pritët për përfaqësuesen e paditëses nuk e ka filluar seancën deri në ora 9:45 minuta, mirëpo përfaqësuesja e paditëses B.G, vetëm përmes telefonit e ka kontaktuar zyrtaren e gjykatës, duke kërkuar që gjykata mos të filloj seancën në kohën e paraparë por të

pritet për gjysmë ore sepse orarin e kësaj çështje e ka ngatërruar me një lëndë tjetër në këtë gjykatë.

Lidhur me kërkesën që seanca të filloj gjysmë ore pas kohës së përcaktuar, përfaqësuesi i të paditurit nuk u pajtua, duke propozuar që padia e paditëses të konsiderohet e tërhequr, me arsyetimin se paditësja ka qenë e njoftuar me kohë për datën dhe orën e seancës.

Gjykata, vendosi që mos të filloj seanca dhe të pritet paditësja deri në ora 10:05 (35 minuta pas orarit të përcaktuar) por as në këtë orar, të kërkuar nga vet përfaqësuesja e paditëses përmes telefonit, nuk është paraqitur askush si përfaqësues i paditëses dhe në mungesë të tyre, të cilët mungesën për këtë seancë nuk e kanë arsyetuar në asnjë mënyrë formale e prezenca e tyre në seancë nuk u realizua edhe pas pritjes prej 35 minutash për fillim të seancës, gjykata duke u bazuar në nenin 423, par 3 të Ligjit nr. 03/L-006 të Procedurës Kontestimore sipas të cilit thuhet se *“Në qoftë se paditësi nuk vjen në seancën kryesore, edhe pse është thirrur rregullisht, konsiderohet se e ka tërhequr padinë, përveçse kur i padituri deklaron se kërkon që të zhvillohet shqyrtimi kryesor i çështjes në mungesë të paditësit”*, gjykata ka marrë aktvendimin si në dispozitivin I, të këtij aktvendimi, me të cilin vendim padia e paditëses është konsideruar e tërhequr.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, si në dispozitivin II, të këtij aktvendimi gjykata është bazuar në nenin 450 të LPK-së.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL  
2019:242289, C.nr.103/2019, me datë 03.10.2024**

**G j y q t a r i**

---

**Leotrim Gashi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët.